

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ /07/2025

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – PUNË
(PROCEDURË E HAPUR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM.**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ndërtim i linjës 35kV N.St 220 kV Elbasan – Mjekës - Cerruje - Gramsh”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Linja ajrore të energjisë elektrike-31321100 -3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 599,983,516.76 (Pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.1.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tre viteve të fundit financiare (2022-2023-2024). Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e fondit limit të procedurës së prokurimit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

2.2.2 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: 599,983,516.76 (pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.** (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit financiare 2022-2023-2024. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, Dega e Tatim Taksave.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii)

shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së për vitin e fundit, sipas ligjit nr. 9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga njësite ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin e fundit.

Pika 2.2.3 konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit plotësojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , sipas shtojcës 8 .

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). (Kjo kerkese do te konsiderohet e përmbushur gjate fazës se ofertimit me plotësimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet te paraqesë përpara nënshkrimit te kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet 299,991,758.38 (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet 1,199,967,033.52 (pa TVSH).

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e bën oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.

- Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- 1.1 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.2 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 299,991,758.38 lekë (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 1,199,967,033.52 lekë (një miliard e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e tre pikë pesëdhjetë e dy).lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (2.3.1/a-2.3.1/b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 2.3.1/a dhe 2.3.1/b, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si

dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jepen të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: ***”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2.3.2 a) ***Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.***

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1	Punime gërmimi në tokë	Klasifikim C
Kategoria NP-2	Ndertime civile dhe industriale	Klasifikim B
Kategoria NP-11	Ndertime për N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Klasifikim E
Kategoria NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Klasifikim B

Kategoria NS-8	Ndertime parafabrikat, beton/arme, struktura metalike dhe druri	Klasifikim C
Kategoria NS-13	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	Klasifikimi B
Kategoria NS-14	Impiante të brendëshme, elektrike, telefoni, etj.	Klasifikimi A
Kategoria NS-18	Punime topogjeodezike.	Klasifikimi A

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj licensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shenim: Ne rast pjesëmarrjeje të një Operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, Licencën e mesipërme me kategoritë e pershkuara, duhet ta ketë të njehsuar pranë organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të saj në fuqi.

Shënimi: Në zbatim të nenit 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor lejon mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet, apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mesipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.

Kjo kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe të lidhura ngusht me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Referuar *N.P-1 (Punime gjurmimi në tokë)*, në preventivin e punimeve ka zera që kanë të bëjnë me gjurmimin e bazamenteve në tokë ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me piken *N.P-1*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.
- Referuar *N.P-2 (Ndertime civile dhe industriale)*, në preventivin e punimeve ka zera që kanë të bëjnë me ndertimin e godinave të nenstacioneve (godina industriale), ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me piken *N.P-2*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.
- Referuar *N.P-11 (Ndertime për N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)*, në preventivin e punimeve pjesa më e madhe e zerave dhe natyra e vetë këtij objekti kërkojnë që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me piken *N.P-11*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.
- Referuar *N.P-12 (Punime të Inxhinierisë së mjedisit)*, duke marrë në konsideratë standartet për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis për objektin e prokurimit, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë *N.P-12* ku bëjnë pjesë *Punime të Inxhinierisë së mjedisit*.
- Referuar *N.S-8 (Ndertime parafabrikat, beton/arme, struktura metalike dhe druri)* Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me struktura metalike si janë shtyllat e tipit kulle, apo elemente të tjera beton arme të bazamenteve të shtyllave, për këtë është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë *N.S-8*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.
- Referuar *N.S-13 (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)* në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punimet e kategorise së telekomunikacionit ku përfshihet instalimi i fibër optike që do shërbejë për komunikimin nëpërmjet nenstacioneve, gjithashtu në këtë preventiv ka dhe punime ndërtim të godinave të reja që do përisen me sisteme elektrike dhe telefonie/telekomunikacioni, për këtë është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë *N.S-13*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.
- Referuar *N.S-14 (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, etj.)* në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punimet për ndërtim të godinave të reja që do përisen me sisteme elektrike, internetit, telefonie etj...) ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me piken *N.S-14*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.
- Referuar *N.S-18 (Punime topogjeodezike)* në preventivin për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punimet topogjeodezike / topografike si piketimet e linjës apo

dhe nenstacioneve. ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me piken N.S-18, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.2 b) *Licensa profesionale ne fushen e projektimit.*

Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale ne fushen e projektimit ose te kete marrveshje kontraktuale me disponuesit e ketyre licencave, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorit e meposhtme:

<i>Projektues konstruktor</i>	- Pika 3/a,b
<i>Projektues instalator</i>	- Pika 4/c
<i>Projektim impianteve ... te shpernd. en. elektrike</i>	- Pika 10/d
<i>Projektues elektronik/telekomunikacion</i>	Pika 4/j

Argumentimi: Keto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe punimet përkatëse për objektin e prokurimit, këto janë proporcionale dhe te lidhura ngushtë me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentim teknik për kërkesën mbi licencat profesionale në fushën e projektimit

Në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin teknik të objektit të prokurimit, që përfshin **ndërtimin e linjave të tensionit të lartë dhe dy nënstacioneve të transmetimit**, realizimi i këtij projekti kërkon përfshirjen e ekspertizës së specializuar në fushën e projektimit të strukturave, instalimeve elektrike, impianteve të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe sistemeve të elektronikës dhe telekomunikacionit. Për këtë arsye, në dokumentet e tenderit është përcaktuar që **Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licenca profesionale përkatëse**, ose të ketë marrëveshje kontraktuale me subjektet që i zotërojnë këto licenca, të lëshuara nga organet kompetente për licencimin e shërbimeve të projektimit.

Konkretisht, kërkohet që dokumentacioni i ofertës të përfshijë licencat ose marrëveshjet për këto kategori projektuesish:

- **Projektues konstruktor – Pika 3/a, b:** për projektimin e strukturave mbajtëse të linjave dhe objekteve ndihmëse në nënstacione, duke garantuar siguri dhe stabilitet mekanik sipas normave të ndërtimit.
- **Projektues instalator – Pika 4/c:** për projektimin e instalimeve elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm brenda nënstacioneve, duke përfshirë pajisje ndërruese, ndarëse, mbrojtëse dhe sistemet e tokëzimit.
- **Projektues për impiantet e shpërndarjes së energjisë elektrike – Pika 10/d:** për projektimin e linjave të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike që përbëjnë rrjetin primar dhe sekondar.

- **Projektues elektronik/telekomunikacion – Pika 4/j:** për projektimin e sistemeve të mbikëqyrjes, SCADA, sinjalizimit, matjes së parametrevë në distancë, komunikimit dhe kontrollit automatik të rrjetit, që janë thelbësore për funksionimin dhe monitorimin në kohë reale të nënstacioneve.

Këto licenca përbëjnë një **garanci teknike dhe ligjore** që operatori ofertues ka kapacitetin profesional dhe ekspertizën e nevojshme për të realizuar projektimin e plotë dhe të sigurt të komponentëve të kësaj veprë energjetike të rëndësishme.

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktoje disponuesit e këtyre licencave, nëse nuk janë pjesë e stafit të tij, me qëllim realizimin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur, ose me kontratë shërbimi për periudhën e kryerjes së punimeve të kontratës, me një program të licencuar “PLS CADD and TOWER” ose të ngjashëm, si dhe një person të certifikuar për përdorimin e këtij programi.

1. deshmi/licence e paisjes me program të licencuar
2. certifikatat e punonjesit të certifikuar
3. listpagesat E-Sig të punonjesve të sipercituar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kjo kërkesë është e nevojshme pasi në këto mënyra mund të bëhet llogaritja, projektimi i linjave, analiza e ngarkesave mekanike dhe elektrike të linjave tensionit të lartë.

Gjithashtu në mënyrë që të mos këto kufizime tregu në ofertim është lënë mundësia dhe për aplikacione të tjera të ngjashme mjafton që kopja elektronike e projektit të jetë në formatin “.bak” file në mënyrë që projekti të jetë i lexueshëm nga softet.

Por është e domosdoshme që një operatori ekonomik ose personi që do të hartojë projektin të ketë një licencim ose trajnim personal që dëshmon kapacitetin teknik dhe aftësinë në përdorimin e këtij softi apo softëve ekuivalente.

Me anë të softit PLS CADD ndërtohet profili gjatësor, llogariten varjet e përcjellesit, si dhe nxirren ngarkesat në struktura të shtyllave nga përcjellesit.

Ky është një kriter i nevojshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me të, me qëllim për të vërtetuar kapacitetet e ofertuesit mbi realizimin me sukses të objektit të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky aplikacion shërben dhe është i lidhur ngushtësisht me realizimin e kontratës objekt procedure prokurimi. Ky aplikacion nuk e kufizon konkurrencën për shkak se mund të blihet lehtësisht nga çdo OE ofertues.

2.3.4 Operatori ekonomik (ne baze te VKM 312 Dt.05.05.2010 per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier) duhet te kete te pakten 10 (dhjetë) punonjes te trajnuar dhe te pajisur me çertifikate te punimeve ne lartesi te leshuara nga shoqeri te licensuara nga ministria perkatese, te cilet te jene te siguruar te pakten per 3 (tre) muajt e fundit.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- i) çertifikatat e punonjesve per punimet ne lartesi**
- ii) listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar.**

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me stafin teknik **10 (dhjetë) punonjes te trajnuar** te certifikuar per punime ne lartesi, argumentohet se realizimi i punimeve objekt kontrate kerkon punonjes qe kane aftesite fizike dhe teknike per te punuar ne kushte te veshtira pune, ne shtylla tensioni te larte dhe ne lartesi nga toka.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej 50 punonjës per 3 muajt e fundit duke marre si reference daten e hapjes se tenderit; te paraqitura dhe te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore per periudhen e mesiperme, nga te cilet duhet te kete specialistet si me poshte:

- 15 (pesëmbëdhjetë) elektrikiste punonjës specialist të pajisur me OMVK ne perputhje me kerkesat ose standartet ekuivalente te cilet duhet te kene njohuri teorike dhe praktike të teknologjisë së instalimeve të tensionit të lartë dhe të rregullave që mundësojë montimin, ripariminin, mirëmbajtjen, çmontimin e instalimeve të tensionit të lartë në përputhje me kategorinë e tyre për elektrikist.**
- Ku minimalisht 5 (pesë) specialist të kenë kategorine, e IV ose më e lartë dhe pjesa tjeter te jene te pajisur me OMVK per elektrikist.**

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën tre muajt e fundit.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajt e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistet e fushës kanë bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregojnë besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 50 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është min **50 punonjes**.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar/ose me kontratë shërbimi si drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë të pakten 1 (një) inxhinier ndertimi, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier elektrik.*

Inxhinieret e mesiperm duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë në listepagesat perkatese E-Sig per 3 (tre) muajt e fundit.

- Ing. Elektrik 1 (një)
- Ing. Ndertimi 1 (një)
- Ing Mekanik 1 (një)

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij dhe në listepagesat e shoqërisë ose me kontratë shërbimi për periudhën e kryerjes së punimeve të kontratës.

- Ing Mjedisori 1 (një)
- Ing. Gjeodet 1 (një)
- *Gjithashtu si pjesë e stafit të tij ose me kontratë shërbimi, ofertuesi përveç inxhinierve të mesiperm duhet të ketë dhe 1(një) inxhinier i pajisur në certifikatë Auditim Mjedisori. Inxhinieri i mesiperm duhet të jetë i siguruar dhe të figurojë në listepagesat perkatese E-Sig per 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten CV-të, deshmimet/certifikatat ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të pakten periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

ARGUMENTIM: Në lidhje me kërkesën për inxhinieret e kerkuar, është vendosur duke marrë në konsideratë volumin e punimeve objekt kontrate dhe për ti dhënë siguri Autoritetit Kontraktor që OE fitues do të arrijë të realizojë punimet e kerkuara. Numri i personelit kryesor i nevojshem për këtë kategori është minimal dhe nuk kufizon konkurrencën. Këto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me piken 6/c të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, si dhe me Nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Për sa i takon inxhinierit të ndërtimit të kërkuar, janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinierët e ndërtimit janë ekspertët kryesor për projektimin dhe zbatimin duke patur parasysh natyrën e investimit që do të kryhet.

- Për sa i takon inxhinierit elektrik të kërkuar, është të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri elektrik do të ndjekin ecurinë e punimeve elektrike që nga projektimi deri në zbatimin e plotë të investimit, duke patur parasysh natyrën e investimit që do të kryhet.

-Për sa i takon inxhinierit gjeodet të kërkuar, është i nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri gjeodet do të jetë pjesë aktive e procesit të projektimit dhe zbatimit të kontratës duke bërë të mundur matjet dhe rilevimet topografike dhe batimetrike të kësaj kontrate specifike.

- Për sa i takon inxhinierit mjedisit të kërkuar, është të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri mjedisit do të ndjekin ecurinë e punimeve që kanë të bëjnë me ndërhyrjet që do të behen në mjedis si hermime, hapje traseje rrugeshe, kalim neper zona pyjore, shtrate lumenjsh, basene liqenesh etj.

-Për sa i takon inxhinierit mekanik të kërkuar, është të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri mekanik do të ndjekin ecurinë e punimeve mekanike si montime dhe demontime të pajisjeve dhe konstruksioneve mekanike të investimit në rastin konkret sic janë shtyllat e kesaj linje si pjesë e këtij e projekti te shprehura ne preventivin perkates.

AK argumenton se kërkesa për inxhinieret është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë shërbimi për periudhën e kryerjes së punimeve të kontratës, 1(nje) inxhinier i pajisur ne certificate Auditim Mjedisor. Inxhinieri i mesiperm duhet te jete i siguruar dhe te figuroje ne listepagesat perkatese E-Sig per 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

c) Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë:

Licence leshuar nga QKL për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me kod III.2.B (transportimi i mbetjeve të llojeve të ndryshme).

Nëse Operatori Ekonomik ofertues nuk i disponon këto licence, atëherë ai mund të bëjë një marrëveshje kontraktuale me personin fizik apo juridik që i disponon këto licence.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Përse i përket kërkesave, për licence me kod III.2.B, dhe inxhinier i pajisur në certifikatë Auditim Mjedisor këto kërkesa janë bërë duke patur parasysh qëllimin dhe rreziqet e ndotjes mjedisore që mund të shkaktojnë këto kontrate gjatë zbatimit të saj, për shkak të grumbullimit, transportimit dhe ndikimit në mjedisin e kantierit të punimeve, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është në përputhje me Fushën III “Mjedisi dhe burimet mjedisore bazë”, Kategoria III.2, Pika 9, e VKM Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Ky është një kriter i nevojshëm dhe i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me to, me qëllim për të vërtetuar kapacitetet e ofertuesit mbi realizimin me sukses të objektit të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë shërbimi për periudhën e kryerjes së punimeve të kontratës, 1(një) Inxhinier elektrik të certifikuar për: arkitektura dhe skemat e Nënstacioneve elektrike të TL; mbrojtje dhe komandime; Scada/RTU dhe rele, të cilët duhet të jenë të siguruar jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

1. Diplomë/Dëshmitë e punonjësve
2. Listat e E-Sig të punonjësve të sipërcituar

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për inxhinierin e sipërcituar është e lidhur me objektin e kontratës dhe natyrën e profilit të inxhinierit elektrik, si dhe në mbështetje me natyrën specifike që kanë këto pjesë të rendesishme të kontratës objekt prokurimi. Kjo kërkesë për kualifikim është në përputhje me pikën 6/c, të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar ose me kontratë shërbimi të pakten 2 manovratore, të cilët duhet të jenë të pajisur me kartele personale të sigurimit teknik, të leshuar nga organet kompetente, të cilët të jenë të siguruar të pakten për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës (nese automjetet janë në pronësi të OE ofertues).

Në rastin kur automjetet merren me qira, manovratori i pajisur me kartele personale të sigurimit teknik, mund të kontraktohet nga OE ofertues për realizimin e kontratës objekt procedure prokurimi.

Në lidhje me manovratorin e makinerive të renda të paraqiten deshmite e drejtimit të leshuar nga Ministria perkatese.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me punonjësit manovrator të kërkuar, theksojmë se këta punonjës duhet të disponohen dhe të kenë eksperience të nevojshme për të bërë të mundur levizjet brenda kantierit të nderimit, duke patur në konsideratë kufizimet e mundshme brenda territorit të kantierit.

Këto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar ose me kontratë shërbimi, mjekun e shoqërisë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve të VKM-se Nr.692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742 date 06.11.2003.

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këto kërkesa duke pasur në konsideratë edhe parashikimin e pikes 12/2 të VKM-se Nr. 692 date 13.12.2001, i ndryshuar). Duke mbajtur në konsideratë parashikimet e pikës 3 të nenit 88

të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Referuar ligjit Nr.10237 date 18.02.2010 per sigurine dhe shendetin ne pune neni 23 pika 1. Cdo kompani duhet te kete te punesuar ose me kontrate sherbimi nje mjek per ofrimin e sherbimit te mjekut te kompanise. Per arsye te organizimit dhe monitorimit te veprimtarise se sigurise dhe shendetit ne pune, kontrollin /inspektimin periodik per gjendjen e masave mbrojtese ne pune dhe zbatimin e rregullores se sigurise dhe shendetit ne pune nga te gjithe punonjesit.

Trajnime per punonjesit per dhenine e ndihmes se pare apo shmangien e reziqeve qe mund te ekzpozohen punonjesit.

Ndjeka dhe analizimi i te dhenave ne lidhje me aksidentet ne pune apo semundejet profesionale.

2.3.10 Operatori ekonomik (ne baze te Ligjit 10237, dt. 18.02.2010, neni 5, pika 15) per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier) duhet te kete te pakten 1 (nje) person te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me risk te larte, dhenien e ndihmes se pare dhe menaxhim emergjencash, i cili te jete i siguruar te pakten per 3 (tre) muajt e fundit dhe duhet te jete prezent ne kantier gjate ekzekutimit te punimeve.

Certifikata te jete e leshuar nga shoqeri te licencuara nga ministria perkatese.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:

1. Çertifikaten e inxhinierit;
2. Licencen e shoqerise e cila ka trajnuar punonjesit e operatorit ekonomik;
3. Listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Persa i perket kerkeses per nje person te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me rrisk te larte, argumentohet se eshte i nevojshem te qendroje ne kantierin e punimeve per te ndjekur ecurine e punes se punonjesve te OE ofertues dhe te jete i gatshem ne rastin e paraqitje se kushteve te rrezikshme qe mund te ndodhin gjate

zbatimit të kontratës objekt prokurimi, në përputhje me Ligjin Nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.11 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.

Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të jete **Ing. Elektrik** ose **Ing. Mekanik** dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

1. Librezë pune
2. Kontratë pune e vlefshme
3. Diplomë

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve në ndërtim, mjedisi, topograf, gjeodet, elektrik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001: "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";
- c) ISO 45001: "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" .

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI/ISO** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana

tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Nr.	Pershkrimi i mjetit	Sasia	Gjendja
1.	Autobetoniere ≥ 3.5 m ³ për punime në kantiere	2(dy) copë	Pronësi ose me qera
2.	Kamion transportues vetë shkarkues me Vinc mbi 5 Ton	2(dy) copë	Pronësi ose me qera
3.	Kamion me Vinc mbi ose 20 ton	1(nje)copë	Pronësi ose me qera
4.	Eskavator	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
5.	Fadrome	1(nje)copë	Pronësi ose me qera
6.	Tokmak	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
7.	Motoarganillo	2 (dy) cope	Pronësi ose me qera
8.	Makineri tërheqje percj.,tros, opgw mbi 35 kN	2 (dy) sete	Pronësi ose me qera
9.	Makineri lëshuese (frenuese) percj.,tros, opgw mbi 35 kN	2 (dy) sete	Pronësi ose me qera
10.	Falkone (pa motoarg.)	2 (dy) cope	Pronësi ose me qera
11.	Instrument për matjen e dispresionit kromatik me shtrirje dinamike min 55 db	1 (nje) cope	Pronësi ose me qera
12.	Terameter	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
13.	Megaohmeter ≥ 5000 volt	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
14.	Kenotron për kabllo	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
15.	Set veglash për kabllo, (Motoperse Hidraulike ≥ 120 Ton)	2 (dy) sete	Pronësi ose me qera

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike në pronësi/qira do të paraqiten këto dokumenta:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse;

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe

kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- c) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim permbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazes së nënshkrimit të kontratës do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

2.3.14 Per listen e meposhtme te mallrave:

- *Shtyllat metalike*
- *Percjellesin ACSR 240/40 mm²*
- *OPGW*
- *Kabellin Al, 35 kV 1x240 mm²*
- *Çelat 35 kV*
- *Izolatore*
- *Morseteri terheqese dhe mbajtese*

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

1. *Autorizim të prodhuesit/ve/distributorit të autorizuar për listën e mesipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*
2. *Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/për listën e materialeve të mesipërme që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike bazë të përkthyer në gjuhën shqipe.*

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

3. *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi i kryera*

me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standartet SSH/IEC/DIN/EN..Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqese deshmi të testimeve (type test ose rutine test) zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi.

Shenim: Testet duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Duke marrë parasysh që e gjithë lista e kërkuar përbehet nga pajisje të vecanta që përdoren në N/stacione elektrike, kërkohet nga prodhuesi që të deshmojë se është prodhues i certifikuar nga institucione ndërkombëtare sipas standarteve IEC/EN/SSH. Kriteri I kërkuar në lidhje me testet tip ose rutine të produkteve të kërkuara nga prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqese: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin. Gjithashtu katalogu duhet të jetë në gjuhën shqipe.

Shënim: Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fitesit do t’i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të

LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III. Argumentimi i specifikimeve teknike.

Referuar VKM Nr. 285_date 19.05.2021_Rregullat e Prokurimit Publik, e ndryshuar kjo kontrate do te trajtohet si nje kontratë:

a) me çelësa në dorë:

- i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

- ii. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.

Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Reflektim: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

2.3.3 Afati i kryerjes se punimeve është: 18 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.

Operatori Ekonomik duhet te paraqese grafikun e punimeve ne perputhje me afatin kohor qe eshte lene ne dispozicion per realizimin e kontrates.

SHENIM: Kudo që është përdorur fjala “importi” zëvendësohet “importi ose ekuivalent”.

Shenim: Referuar VKM Nr. 285_date 19.05.2021_Rregullat e Prokurimit Publik, e ndryshuar kjo kontratë do të trajtohet si një kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në preventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të dhena.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

Afati i realizimit të objektit të kontratës, u caktua ;

Realizim brenda një periudhe 18 muaj nga dorezimi i sheshit të ndertimit, u mendua se është i realizueshëm për volumnin e punëve që përmban projekti.

Kjo periudhe është vlerësuar: brenda (2 muaj) pas lidhjes së kontratës OE duhet të paraqesë projekti-preventivin përfundimtar i cili do të jetë i detyrueshëm për zbatim, pas miratimit nga ana e AK-se.

Dhe 18 muaj nga dorezimi i sheshit të ndertimit do të jenë për të realizuar punimet.

Të gjitha kërkesat dhe shtojcat e tjera u hartuan në përputhje me dokumentet standarte.

Vendosja e të gjithë ketyre kritereve e siguron Autoritetin Kontraktor se ofertuesi ka kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të tjera nga shqipja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe;

Garancia e punimeve, në vlerën prej 5% të preventivit, do të rikthehet operatorit ekonomik fitues 2 vite pas kolaudit të punimeve.

Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961;

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Bazuar në relacionin e ardhur nga grupi i punës i ngritur me nr prot 714/2 datë: 18.07.2024 “Për përlogaritjen e fondit limit”, ku bashkëlidhur kanë sjellë në sektorin e prokurimeve, specifikimet teknike, kriteret e veçanta kualifikuese objekt prokurimi. Specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

Njësia e Prokurimit bëri llogaritjen e afateve dhe vendosi që duke filluar nga data e hedhjes në sistem data e fundit e pranimi të ofertave dhe e zhvillimit të prokurimit të jetë data 05.08.2024 ora 12.00

Personi i autorizuar për të ngarkuar në sistem DST dhe gjithë dokumentat e tenderit do të jetë Z. Aleksandër Pjetri.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

❖ Njesia e Prokurimit